



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

1. Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomikë “NIKA” sh.p.k & “ERALD-G”sh.p.k
2. Adresa: Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi Skënderbeu, Godinë 8-katëshe, Kati i I-rë, Zona kadastrale 8593, Nr.Pasurie 5/587”4001, Shkodër; Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private private Nr.61, Dibër:

NIPT: J76705047U & K36306784K

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

3. Tipi i Kontratës: Punime ndërtimi
4. Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur
5. Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-92527-07-06-2026**
6. Objekti i kontratës: **“Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinës 10 në zonën zhvillimore “Kombinat”.**
7. Fondi limit: **288,663,346.67** (dyqind e tetëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
8. **Burimi i financimit:** me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, miratuar me VKB Nr.100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026” të miratuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. Prot 43563/1, datë 29.12.2025”.
9. Kohëzgjatja e kontratës: Afati i kryerjes së investimit është 15 muaj kalendarikë, 2 muaj për realizimin e projekt zbatimit.
10. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **07.07.2026**
11. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike **Nr.45**, datë **13 Korrik 2026**.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Operatori ekonomik “2 N” sh.p.k

NIPT: L31615017L

Vlera: 283,000,000 (dyqind e tetëdhjetë e tre milion) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒**2.Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “B93 II” sh.p.k & “ASI-2A CO”sh.p.k**

NIPT: L52209050O & K53002402C

Vlera: 277,950,000 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒**3.Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “C O L O M B O” sh.p.k & “TAULANT”sh.p.k & “AGI KONS”sh.p.k**

NIPT: J82916489E & K61617040L & K21622001M

Vlera: 246,516,158 (dyqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒**4. Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k**

NIPT: J67902718S

Vlera: 271,320,000 (dyqind e shtatëdhjetë e një milion e treqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒**5. Operatori ekonomik “DION-AL” sh.p.k**

NIPT: K67917301H

Vlera: 240,550,000 (dyqind e dyzet milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒**6. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “ED KONSTRUKSION” sh.p.k & “O.B.KONSTRUKSION”sh.p.k & “ZENIT&CO”sh.p.k**

NIPT: K61625001I & K93728201A & K61731002D

Vlera: 210,500,000 (dyqind e dhjetë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

7. Operatori ekonomik “INA” sh.p.k

NIPT: J61814009W

Vlera: 262,804,876.91 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

8. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “INERTI” sh.p.k & “INFRATECH”sh.p.k

NIPT: J66926804L & K91628001D

Vlera: 265,279,521.62 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e një pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

9. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “MF INVEST GROUP” sh.p.k & “C.E.C GROUP”sh.p.k & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION”sh.p.k

NIPT: L71830010R & L11807013M & K91628013D

Vlera: 262,300,000 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy milion e treqind mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

10. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “NIKA” sh.p.k & “ERALD-G”sh.p.k

NIPT: J76705047U & K36306784K

Vlera: 233,817,310 (dyqind e tridhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

11. Operatori ekonomik “PEPA GROUP GROUP” sh.p.k

NIPT: L42215009L

Vlera: 239,590,577.73 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “PEPA GROUP GROUP” sh.p.k

Operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.8 ku është kërkuar: *“Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: 1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa...”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “Scan Energji” Shpk për 1 (një) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia për Eficensen e Energjisë për të kryer auditime në Ndërtesa, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, cka bie në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*.

Operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.12 ku është kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: 1 (një) Teknik Mekanik...”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “AL-STEEL CONSTRUCTION 01” Shpk për 1 (një) Teknik Mekanik, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*.

Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “MF INVEST GROUP” sh.p.k & “C.E.C GROUP”sh.p.k & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION”sh.p.k

Operatori ekonomik “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, gërma h) ku përcaktohet se: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8)... konkretisht: Kamion me kapacitet 10-20 ton copë 3, Gazogjen copë 1, Kamioncine me kapacitet deri 3.5 ton copë 2...”* *“Operatori/et ekonomik ofertues duhet të*

deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me autoritetin kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk ka deklaruar mjetet Kamion me targe AB062EI, Gazogjen Fat. 38, Kamioncinë me targe AB 902 GB, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt: “Ndertimi i rruges “Arben Mekshi” dhe “Joklin Persi” lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

Operatori ekonomik “2 N” sh.p.k

Operatori ekonomik “2N” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.5, ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: a)Librezë pune; b)Kontratë pune e vlefshme; c)Diplomë”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “2N” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve me kohë të plotë në kantier punonjësen me inicialet I.T, e cila rezulton të jetë e angazhuar në kontratën me objekt: “Rehabilitimi I rrugeve Hamide Dalipi, Ismail Klosi dhe degezimet e tyre”, lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare*

Operatori ekonomik “2N” Shpk shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”: Rrul me (Kompresor me vibrim) copë 2, Asfaltoshtruese copë 2, Grejder copë 2, Autobitumatriçe copë 2, Kamion me kapacitet 3-5 ton copë 1, Autobot uji copë 1, Eskavator me goma copë 1, Kamion me kapacitet 10-20 ton copë 2..etj gërma g) ku përcaktohet se: “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “2N” shpk ka deklaruar mjetet Kamion me kapacitet 10-20 ton me targë AA991IN, Autobot Uji me targë AA264TV, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt: “Rehabilitimi i rrugeve Hamide Dalipi, Ismail Klosi dhe degezimet e tyre”, lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomikë “NIKA” sh.p.k & “ERALD-G”sh.p.k** me NIPT: J76705047U & K36306784K dhe adresë: Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi Skënderbeu, Godinë 8-katëshe, Kati i I-rë, Zona kadastrale

8593, Nr.Pasurie 5/587”4001, Shkodër; Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private private Nr.61, Dibër; se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **233,817,310** (dyqind e tridhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH është identifikuar si ofertues i sukseshëm. Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.